



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR VITIN 2026

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	08.01.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me afatin ligjor për shpalljen e vendimit përfundimtar të arsyetuar të çështjes me kërkes kryebashkiakun e Tiranës Erion Veliaj, më konkretisht: 1.Përse nuk është publikuar vendimi i përfundimtar i arsyetuar? 2. Kur do të publikohet?	14.01.2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për çështjen që ju interesoheni është shpallur i arsyetuar dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës në linkun e mëposhtëm: https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/vend.6625.pdf	E plotë	Nuk ka

		3. Përse janë shkelur afatet ligjore? 4. Cila ka qenë pengesa për trupën gjyqsore? 5. Përse janë bërë publikimet përfundimtare të arsyetuara për çështjet e tjera të shqyrtuara nga GJK gjatë muajve tetor, nëntor, dhe për rastin konkret jo?				
2.	12.01.2026	Kërkesë për informacion për interes të redaksisë së Neës 24 në lidhje me vonesat në zbardhjen e 3 vendimeve, konkretisht: 1.Shkarkimin e z.Erion Veliaj	14.01.2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se vendimet e Gjykatës Kushtetuese për çështjet që ju interesoheni janë shpallur të arsyetuara dhe gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës në linqet e mëposhtme:	E plotë	Nuk ka

		2.Vendimi për mandatin e zonjës Sonila Bejtja (kërkesë e Presidentit) 3.Rasti i kërkueses Onejda Imeraj (sekueustro telefoni)		https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/vend.4425.pdf https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/vend.6025.pdf https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/vend.6625.pdf		
3.	23.01.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me çështjen me kërkues kryeministrin e vendit, më konkretisht: Për shkak të ndjeshmërisë së lartë që mbarë kjo çështje, po kërkoj informacion për mbledhjen e ardhshme të		Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se data dhe ora do t'ju komunikohen sipas rregullave dhe afateve ligjore.	23.01.2026	Nuk Ka

		trupës së Gjykatës Kushtetuese, kur pritet të bëhet dhe dhe vendimmarrja.				
4.	19 shkurt 2026	Kërkesë për informacion në lidhje me vendimin e marrë nga Gjykata Kushtetuese, datë 06.02.2026 për kërkesën e paraqitur nga qeveria lidhur me vendimin e GJKKO. Me konkretisht: 1.Pse nuk është botuar vendimi ende në Fletoren Zyrtare? 2.A do të thotë mosbotimi i tij se vendimi nuk ka hyrë ende në fuqi dhe, për rrjedhojë, nuk prodhon efekte juridike?		Pas marrjes në shqytim të kërkesës, kërkesit nuk i është kthyer përgjigje pasi vendimi i arsyetuar i Gjykatës Kushtetuese nuk ishte shpallur akoma. Vendimi i arsyetuar është shpallur në datën 03.03.2026.		

5.		Kërkesë për informacion në lidhje me Vendimin e Gjykatës së Lartë Nr. 00-2025-2121 nëse është paraqitur ose jo ankim në Gjykatën Kushtetuese nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan “Harry Fultz” dhe/ose nga Këshilli i Ministrave.		Në përgjigje të e-mail-it, tuaj datë 09.03.2026, me objekt “<i>kërkesë për informacion</i>”, ju informojmë, se në datën 17.09.2025 është paraqitur dhe regjistruar në Gjykatën Kushtetuese kërkesa e kërkuarit Fondacioni Shqiptaro-Amerikan “Harry.T.Fulz”, me objekt: “<i>Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-2121, datë 27.05.2025 i Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë</i>”, e cila mban numrin 28 (F) 2025 të regjistrimit themeltar të kërkesave, datë 17.09.2025.	12.03.2026	Nuk ka

				Kolegji i Gjykatës Kushtetuese me vendimin e datës 10.11.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve si dhe thirrjen si subjekte të interesuara në këtë proces të Genci Beqiri, Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë. Gjithashtu, ju informojmë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht në linket e mëposhtme, https://ww.gjykatakushtetuese.gov.al/kerkesat-e-rregjistruara-shtator-2025/; https://www.gjykatakushtetuese.gov.al/vendime-te-muajit-nentor-2025/.		
--	--	--	--	--	--	--

6.		Kërkesë për informacion në lidhje me procedurat e aksesit, orientimit dhe ofrimit të shërbimeve për publikun pranë Gjykatës Kushtetuese, konkretisht për çështjet e mëposhtme: 1.A ka sportele të sekretarisë gjyqësore për depozitimin e kërkesave të thjeshta ose për sigurimin e kopjeve të dokumenteve të palëve në gjykim; nëse jo, si operohet në praktikë? 2.A ka persona përgjegjës për orientimin dhe informimin e publikut në hyrje të Gjykatës dhe cili është statusi i tyre		Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara në kërkesat tuaja për informacion, të datave 22 maj dhe 19 qershor 2026, lutemi gjeni në vijim informacionin në lidhje me procedurat e aksesit, orientimit dhe ofrimit të shërbimeve për publikun pranë Gjykatës Kushtetuese si më poshtë: 1. Kërkesat për ankimin kushtetues individual, si dhe çdo kërkesë tjetër drejtuar Gjykatës Kushtetuese, depozitohen pranë zyrës së Protokoll-Arkivit, e cila ndodhet në katin e parë të godinës së Gjykatës. Orari zyrtar për paraqitjen e kërkesave është nga ora 08:00 deri në orën 16:00, çdo ditë pune, nga e hëna në të premte.		
----	--	--	--	--	--	--

		funksional (personel sigurie, administrativ apo tjetër)? 3.Gjithashtu, ju lutem të specifikoni nëse këta persona mbajnë elementë identifikues zyrtarë gjatë ushtrimit të këtij funksioni. 4.Cila është porta kryesore e hyrjes në Gjykatë për publikun / palët që dëshirojnë të depozitojnë kërkesa, të tërheqin kopje aktesh ose dokumentesh, apo të marrin pjesë në seanca gjyqësore (hyrja në Gjykatë është nga dera përballë Kryeministrit apo nga një hyrje tjetër)? 5.Cili është sporteli ose zyra konkrete ku bëhet depozitimi i kërkesave për kopje aktesh / procesverbalesh në cilësinë e		2. Në hyrje të Gjykatës Kushtetuese, orientimi i publikut realizohet nga punonjësit e sigurisë, të cilët janë të pajisur me elementët përkatës identifikues gjatë ushtrimit të detyrës. Këta punonjës orientojnë qytetarët dhe palët e interesuara drejt zyrës së Protokoll-Arkivit, ose strukturave të tjera përkatëse, sipas natyrës së kërkesës së paraqitur nga qytetari, në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e brendshme të institucionit. 3. Punonjësit e sigurisë që kryejnë funksionin e orientimit të publikut janë të veshur me uniformë dhe mbajnë dokumentin përkatës identifikues gjatë ushtrimit të detyrës, sipas udhëzimeve dhe rregullave të brendshme të institucionit. 4. Gjykata Kushtetuese ka vetëm një portë kryesore hyrëse, e cila shërben	
--	--	--	--	--	--

		palës kërkuese, duke specifikuar vendndodhjen, katin dhe hyrjen përkatëse për aksesimin e kësaj zyre (nëse hyrja në Gjykatë është nga dera përballë Kryeministrisë apo nga një hyrje tjetër)? 6.Ju lutem të më informoni nëse, në rastin e depozitimit të kërkesave pranë Gjykatës, i dorëzohet kërkuetit kopja e vet e vulosur me vulë institucionale dhe numër protokolli, që konfirmon regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës. 7.Cila është procedura dhe cila është zyra kompetente për depozitimin fizik të kërkesave individuale kushtetuese, duke specifikuar		si për punonjësit e institucionit, ashtu edhe për publikun/palët që dëshirojnë të depozitojnë kërkesa, të tërheqin kopje aktesh ose dokumentesh, apo të marrin pjesë në seanca gjyqësore. Kjo portë ndodhet në anën veriore të godinës së Kuvendit të Shqipërisë, në rrugën që lidh bulevardin "Dëshmorët e Kombit" me rrugën "Ukraina e Lirë"(anash kullave binjake). Porta kryesore hyrëse e Gjykatës Kushtetuese është e identifikuar nga tabela përkatëse me mbishkrimin "Gjykata Kushtetuese" dhe qëndron e hapur gjatë orarit zyrtar (08:00-16:00) nga dita e hënë deri në ditën e premte. 5.Zyra e Protokoll-Arkivit pajis personat që depozitojnë dokumente me formularin “Konfirmim Depozitimi Dokumentacioni në	
--	--	---	--	---	--

		sportelin ose zyrën konkrete ku duhet të paraqitet kërkesa, si edhe katin dhe hyrjen përkatëse për aksesimin e kësaj zyre (nëse hyrja në Gjykatë është nga dera përballë Kryeministrit apo nga një hyrje tjetër)? 8.Cila është mënyra e kryerjes së pagesës për kopjet e akteve gjyqësore, konkretisht nëse pagesa kryhet pranë Gjykatës apo nëpërmjet bankës, si edhe çdo informacion tjetër lidhur me procedurën përkatëse. 9.Në çfarë momenti procedural hidhet në sistemin elektronik të Gjykatës vendimi për moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore,		Gjykatën Kushtetuese”, në të cilin pasqyrohen data dhe ora e depozitimit, emri i depozituesit, si dhe objekti/lënda e dokumentacionit të paraqitur. Ky formular nënshkruhet nga përgjegjësi i Protokoll-Arkivit dhe vulolet në përputhje me procedurat administrative në fuqi. 6. Kërkesat për marrjen e kopjeve të akteve paraqiten në përputhje me nenin 32 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Pjesëmarrësit në gjykim mund t’i drejtohen Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit me kërkesë për t’u njohur me aktet e dosjes gjyqësore dhe për të marrë kopje të tyre. Kërkesa depozitohet		
--	--	---	--	--	--	--

		si edhe kur bëhet i aksesueshëm për palët në gjykim?		pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit të Gjykatës Kushtetuese. 7. Aktualisht, Gjykata Kushtetuese nuk aplikon tarifa për shërbimet që ofron, për rrjedhojë, marrja e kopjeve të akteve gjyqësore kryhet pa pagesë. 8. Vendimmarrjet e kolegjeve, Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe të Gjykatës Kushtetuese publikohen menjëherë në faqen zyrtare të Gjykatës, në rubrikën NJOFTIME MBI VENDIMARRJET – GJYKATA KUSHTETUESE. Vendimet e arsyetuara, përfshirë vendimet e moskalimit të çështjeve në seancë plenare, bëhen të aksesueshme për palët pas nënshkrimit të tyre nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në gjykim. Vendimet publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën		
--	--	--	--	---	--	--

				VENDIME DHE STATISTIKA – GJYKATA KUSHTETUESE , si dhe ju komunikohen palëve në proces nga Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit, sipas adresave të deklaruara në kërkesë.		
--	--	--	--	--	--	--